



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

01 ref. 85
22.04.2022

Mbështetur në nenet 92.4 dhe 93(4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, nenin 46 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese, si dhe nenin 8.1.4 dhe shtojcën 12 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministrija e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nxjerr këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E MASËS MBROJTËSE ANTIDAMPING NË IMPORTIN E BLOKUT STANDARD 19x19x25 NGA SERBIA

1. Caktohet masë mbrojtëse përfundimtare anti-damping prej katër euro centë (0,04€) për njësi në importin e bllokut standard me përmasa 19x19x25 nga Serbia.
2. Masa nga pika 1 e këtij vendimi caktohet ndaj të gjithë importit të këtyre produkteve nga Serbia.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Pas kërkesës së Shoqatës së Prodhuesve të Materialit Ndërtimor nga Argjila dhe propozimit të Komisionit për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe, Departamenti i Tregtisë ka filluar hetimin e importit nga Serbia dhe të shitjes në tregun e Republikës së Kosovës të bllokut standard me përmasa 19x19x25. Hetimi është kryer në përputhje me Ligjin për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese.

Departamenti ka gjetur se blloku standard me përmasa 19x19x25, me origjinë nga Serbia, shitet me çmime më të ulëta në tregun e Republikës së Kosovës sesa në tregun e brendshëm të Serbisë. Departamenti ka gjetur gjithashtu se çmimet e ulëta ka ndikuar

në rritjen e importit. Kjo praktikë dëmton drejtpërdrejt dhe çdo herë e më shumë prodhuesin vendor.

Rrjedhimisht, pas konsultimit me Komisionin dhe duke u thirrur në paragrafët nenin 46 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese ka rekomanduar vendosjen e masës mbrojtëse antidamping si në dispozitiv.

Këshillë juridike: Ky vendim është akt përfundimtar në procedurën administrative. Pala e pakënaqur mund të nisë konflikt administrativ në gjykatën kompetente.



Rozeta HAJDARI

Ministre

U dërgohet:

- Kabinetit
- Doganës
- Anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Departamentit të Tregtisë
- Departamentit Ligjor
- Arkivit